

PËR

PROJEKTVENDIMIN

**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR KRIJIMIN
E REZERVAVE STRATEGJIKE TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË
(TË PAPRERË), RUAJTJEN DHE TRAJTIMIN E PYJEVE TË
VIRGJËR OSE POTHUAJSE TË VIRGJËR, SI DHE KALIMIN E TYRE
NË KONSERVIM TË PLOTË”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i kritereve dhe procedurave të krijimit të rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), që do të shërbejnë si sipërfaqe pyjore të vëna në ruajtje për të përballuar ngjarje madhore.

Gjithashtu në këtë projektvendim janë parashikuar edhe kriteret dhe procedura për ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, të cilët janë të përcaktuara në planet e mbarështimit të ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjore të veçantë, të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër.

Objktivi që synohet të arrihet është krijimi i rezervave strategjike si sipërfaqe pyjore të vëna në ruajtje për të përballuar ngjarje madhore si dhe ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, deri në kalimin e tyre në konservim të plotë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në planet e mbarështimit të fondit pyjor.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME
PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË
TJERA POLITIKE**

Ky projekvendim është parashikuar në Programin Analistik të Projektakteve, për vitin 2021 si akt nënligjor në zbatim të nenit 32, të Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”.

Relacion për projekvendimin “Për kriteret dhe procedurat për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pyjet si pasuri kombëtare, kanë peshë dhe rëndësi të veçantë në zhvillimin dhe progresin e vendit, ndaj duhen pozicionuar në një linjë me politikat dhe objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar, me kontribut të qenësishëm, duke zhvilluar sektorin nëpërmjet një sistemi të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, strategjive, programeve, dhe planeve të mbarështimit, duke integruar dhe optimizuar interesat midis: pyjeve, përdoruesve, mundësive, etj.

Pikërisht një nga objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar si dhe përmbushja e funksionit ekonomik dhe social të pyllit, është edhe krijimi i rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë apo ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjër dhe mundësia e kalimit të tyre në konservim të plotë.

Ky objektiv realizohet më qëllimin e përmbushjes së nevojave të popullsisë me dru zjarri dhe lëndë ndërtimi në rastet e ngjarjes madhore.

Trajtimi i pyjeve të virgjër është i përcaktuar në objektivat e mbarështimit të pyjeve dhe është pjesë përbërëse e planeve të mbarështimit dhe përcakton masat e nevojshme për sigurimin e një mbrojtje afatgjatë të këtyre pyjeve, duke përjashtuar shfrytëzimin e tyre.

Kalimi në konservim të plotë, bëhet bazuar në kriteret ndërkombëtare për konservimin e natyrës sipas IUCN (Unioni Nërkombëtar për Konservimin e Natyrës), por gjithmonë duke mbajtur parasysh nevojat e komunitetit të asaj zone pyjore dhe duke qënë në përputhje me planet e zhvillimit të zonës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës dhe në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti i propozuar nuk synon të përafrojë asnjë dokument të *acquis e BE-së*, pasi është akt që bazohet në legjislacionin e brendshëm të vendit.

Relacion për projektvendimin “Për kriteret dhe procedurat për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet këtij projektakti, parashikohet përcaktimi i kritereve dhe procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë si dhe mënyra e trajtimit dhe ruajtjes së pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër apo mundësia e kalimit të tyre në konservim të plotë.

Në pikën 2 dhe 3, janë parashikuar kriteret për krijimin e rezervave strategjike, të cilat administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Në pikën 4, është parashikuar procedura për krijimin e rezervës strategjike, e cila kryhet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dhe me vetë strukturën përgjegjëse për pyjet në ministrinë përgjegjëse për pyjet.

Gjithashtu është parashikuar në pikën 5, që në rezervat strategjike të miratuara ndalohet të kryhen ndërhyrje silvikulturore, me përashtim të prerjeve shëndetësore, ndalohet kullotja, ndezja e zjarreve, dhënia në përdorim, heqja nga fondi pyjor si dhe ushtrimi i veprimit tarive të tjera të çfarëdo lloji.

Në pikat 6 dhe 7, janë parashikuar kriteret dhe procedurat për ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, të cilët janë të përcaktuar në planet e mbarështimit të ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjore të veçantë të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër.

Në pikat 8 dhe 9, janë parashikuar kriteret dhe procedura për kalimin në konservim të plotë të pyjeve të virgjër, e cila bëhet pas marjes së mendimit të komunitetit të zonës pyjore, konsultimit me aktorët e interesuar dhe miratimit nga këshilli bashkiak i bashkisë ku ndodhet zona pyjore.

Në nenin 10 është parashikuar që, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 734, datë 1.9.2010 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave, për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë”, shfuqizohet.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkitë dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Relacion për projektvendimin “Për kriteret dhe procedurat për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projekvendimi ka kontribuar specialistët e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave dhe Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore).

Projektvendimi do dërgohet për mendim në ministritë e linjës, nëpërmjet sistemit *e-aktet*, konkretisht në Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu, ky projektvendim, do të dërgohet me shkressë zyrtare për mendim edhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për shqyrtim nga Këshilli Konsultativ.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.



Relacion për projektvendimin “Për kriteret dhe procedurat për krijimin e rezervave strategike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë

BASHKIA.....

NGASTRATENENGASTRAT PYORETÉ PROPOZUARASI REZERVĚ STRATEGIČKETÉ LĚNĚS DRUSORE

Shtojca I